

STATUTI I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

TAFA 07 SH.P.K

Në këtë statut

- “Ligji” është Ligji Nr. 9901, dt. 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare”; -
“Statuti” është Statuti i shoqërisë;

Kreu I Themelimi, Emri, Objekti, Kohëzgjatja, Selia

Neni 1:

Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit

(1) Sot, më DATE 05.06.2018, UNE, themeluesi, kam krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin TAFA 07 SH.P.K.

(2) Themeluesit e shoqërisë janë (mbiemrat, emrat ose forma dhe emri ligjor i shoqërisë; adresat ose selia e numri dhe vendi i regjistrimit):

- XHINO TAFA

Neni 2:

Objekti

Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm (vetëm nëse është i përcaktuar):

Sherbime ndermjetesimi online.

Konsulence juridike, financiare, marketing, Biznesi.

IT support, sherbime, mirembajtje hardware, software.

Dizejnim, Printim, zhvillim mirembajtje website.

Prodhim dhe vendosje tabela informuese (Billboard).

Sherbime ne shtepi, biznese : elektrikist, hidraulik, marangoz, bojaxhi, pastrues, shofer, siguri fizike,
siguri objekti, sisteme sigurie , Kamera, Alarme, etj.

Servis, lavazh, karotrec, sigurim dhe kolaudim i makinave, si dhe te gjitha sherbimet e lidhura me mjetet motorike.

Organizim evente familjare, kulturore, artistike, konferenca workshop, seminare.

Import eksport, tregti me shumice dhe pakice, transport brenda dhe jashte vendit.

Import – eksport, tregtimin e artikujve te ndryshem te te gjitha llojeve, me shumice dhe pakice si: Tregtim artikuj te ndryshem industriale.

Tregtim te konfeksioneve te ndryshme.

Tregtim automjesh te cdo lloji, marke e tonazhi, si dhe pjese kembimi per to.

Transport mallrash te te gjitha llojeve brenda dhe jashte vendit.

Punime duralumi e tregetimin e tyre.

Tregetim prodhimesh te ndryshme druri, mobilje, orendi, dyer, dritare etj.

Tregtimin e karburanteve te ndryshme me pakice, si dhe vajrave lubrifikante, te gazte te lengshem per ngrohje si dhe per makinat me impiant gazi, paisje ngrohese gazi si dhe mbushjen e bombolave te gazit dhe tregtimin e tyre me pakice.

Ndertim dhe montim te impianteve per prodhimin e energjise nga burime te ndryshme impiante elektrike per centralet dhe prodhim te transformatoreve, montim i linjave te tensionit te larte dhe te ulet, linjave te ndricimit dhe aparaturave elektrike, mirembajtja e tyre.

Prodhim materiale inerte. Prodhim elemente betoni e b/arme te zakonshem-pararendur, gure dekorative.

Prodhim materiale ne baze bitumi-sintetike. Ndertime civile, industriale, turistike, bujqesore deri ne 5 kate.

Ndertime civile, imdustriale, turistike, bujqesore mbi 5 kate.

Ndertim i objekteve te ndryshme civile dhe industriale; rikonstruksione dhe mirembajtje godinash civile e industriale, veshje fasadash; ndertim rruges, autostrada, punime nentokesore, ura, vepra arti, mbikalime, nenkalime, diga dhe tunele hidroteknike, hekurudha, tramvaje, metro, pista aeroportuale, ujesjelles, gazsjelles, kanalizime, vepra kulluese e vaditese; ndertim fshatrash turistike.

Ndertime detare dhe punime thellimi ne uje, pastrim i ujerave detare, liqenore dhe lumore.

Punim, mbrojtje lumore, sistemime hidroteknike dhe bonifikime, ndertim impiantesh per prodhim energjie elektrike, ndertim i nenstacioneve, kabinave dhe transformatoreve, linja te Tensionit te mesem e te larte, impiante hidrosanitare, kuzhine e lavanteri, impiante ngrites dhe transportues, ashensor, (shkalle levizese), ndertim impiante termik dhe te kondicionimit, ndertime parafabrikat, betonarme, strukture metalike dhe druri, impiante te sinjalistikes ndricuese te trafikut, sinjalistika rrugore jondricuese(fosforeshente).

Ndertim i impiantit te grumbullimit dhe trajtimit te mbetjeve urbane.

Shpime gjeologo-inxhinierike, puse e shpime per uje.

Punime per prishjen e ndertimeve te te gjitha llojeve.

Ndertim, prodhim dhe shitje materialesh ndertimi.

Prodhim inertesh si gur, rere, zhavorr etj me mjete mekanike dhe eksplozive plasës dhe shperthyes.

Pike shitje karburanti.

Tregtim i pjeseve te kembimit per automjete e makineri.

Transport per mallra e pasagjere brenda dhe jashte vendit si dhe servis per automjete.

Tregtim te automjeteve. Shkaterrim demolimin i objekteve te ndryshme industriale, linjave te prodhimit, makinerive e pajisjeve te mjeteve te punes e transportit te klasifikuara si skrap. Grumbullimin, magazinimin, transportimin, perpunimin dhe riciklimin e mbetjeve ferore e jo ferore te (hekur, celik, gize, alumin, baker, bronz e materiale te tjera , si dhe tregetimin e tyre ne tregun vendas, eksportimin/importimin e tyre .

Grumbullimin, magazinimin, transportimin, e materialeve te letres, plastikes, gomes, qelqit, vajrave lubrifikante, e te gjitha materaleve qe jane te riciklueshme.

Veprimtari dhe sherbime hotelerie dhe turizmi, sherbime restorantesh, organizime festash, ceremoni zyrtare, konferenca.

Linja prodhimi ne fushen e artikujve ushqimore, duke perfshire prodhimin e te gjithe llojeve te artikujve ushqimore, si dhe furre buke, pasticeri etj. Veprimtari dhe sherbime ne fushen energjitike, por pa u kufizuar ne to, ndertimin dhe shfrytezimin e hidrocentraleve, prodhimin e shitjen brenda e jashte vendit te energjise elektrike, marrjen me koncension ose me leje dhe shfrytezimin e minierave si dhe perpunimin, transportin, import-eksportin e lendeve minerare apo nenprodukteve te tyre. Veprimtari per shfrytezimin e karrierave dhe guroveve, shfrytezimin e lendeve plasese, shfrytezimin dhe kultivimin e lendes drusore, pyjeve, drureve frutore, kultivimin e bimeve mjekesore, shfrytezimin e tokave bujqesore, ndertim serash, komplekse blegtorale. Veprimtari dhe sherbime ne hapjen e institucioneve arsimore jopublike, kurseve profesionale.

Rikonstruksione.

Punime te mirembajtjes dhe sinjalizimit ne rruge. ndertim mbi shtresa rrugore.

Ndertim ujesjelles kanalizime, kanale e impiante vaditese.

Punime mbrojtjeje te sistemit hidraulik, cimentime etj.

Sillose, kulla, kulla uji etj, b/arme, metalike.

Perforcime themeli e punime nentokesore.

Izolime mbi dhe nentokesore nga ujrat.

Themele te vecanta.

Punime karpenterk druri e metalike.

Instalimi i materialve prej druri, metalike, plastike, xhami etj.

Punime bojatisje, hidroizolimi, termoizolimi, akustike, kundra zjarrit.

Ndertim objektesh te permasave te ndryshme, shtepi, vila, ndertesa shumekateshe ose komplekse pallatesh punime mirembajtje, sherbim fasade.

Ndertim rrugeshe dhe urash si dhe ndertime portuale, detare dhe ajrore si dhe rikonstruksionin e tyre, asfaltim dhe veshje me asfaltim.

Ndertim digash,tunele.

Ndertim vepra kullimi, ujitje, impiante vaditese, punime mbrojtje dhe sisten e hidraulike, punime dhe sistemime elektrike.

Ndertim ambiente dhe sistemim gjelberimi, parqe e lulishte. Import eksport te artikujve te ndryshem si edhe skrap (mbeturina hekurishtesh), transporti dhe pune, traktore fadroma te te gjitha llojeve transportues, makina asfaltimi, makineri e paisje per nyje betoni.

Nyje betoni.

Import-Eksport, aktiviteti ne shperndarjen e tregtimin e organizuar ne baze supermarketesh, ipermarketesh qendra shperndarje cash&cary.

Kompani ndermjetes midis, Kompanive Institucioneve etj, te huaja dhe Shqiptare.

Aktivitetin ne fushen imobiliare, dhenie me qera si dhe shitje te pasurive te luajtshme dhe te paluajtshme individe dhe persona juridik, konsulence ne fusha te ndryshme, rivleresim te pasurive te paluajtshme dhe te luajtshme si dhe cdo aktivitet tjeter te pashprehur persa i perket me siper.

Eksport – import te cdo lloj materiali ndertimi, te paisje kompjuterike dhe elektronike, te makinerive te ndyshme per transport individual dhe publik, te produkteve ushqimore, industriale, kozmetike etj.

Prodhim dhe shitje te energjise elektrike.

Perpunim te metaleve, percaktimin dhe projektimin e te gjitha llojeve te makinave me fluid, projektimin, prodhimin

dhe rimontimin kapital te te gjitha llojeve te hidroturbinave, hidrocentraleve, termoturbinave dhe termocentraleve.

Riprodhimi dhe riparimi i pjeseve mekanike te agregateve elektromekanike si gjeneratore, elektromotor.

Riparimi dhe prodhimi i hidropompave si hidrovoreve, pompe centrifugale industriale dhe ushqimore.

Projektim dhe prodhim per makineri te ndryshme te industrise mekanike.

Prodhim kaldajash te prodhimin e avullit, per industrine dhe termoturbinat.

Ndertimi I mjeteve te lundrimit dhe rimonti capital i agrigateve elektromekanike qe disponojne keto mjete.

Projektimin dhe prodhimin e konstruksioneve te ndryshme mekanike, te veprave hidroteknike si portat e digave, e pastruesit dhe ujembedhesve.

Prodhim instrumenta pune, preres per metale dhe dru te eteknologjise UIK.

Prodhim stampash per industri te ndryshme ushqimore plastike dhe metali.

Prodhim paisjesh dhe makieneri per industrine e minierave.

Projektim dhe prodhim i konstruksioneve ndertimore metalike dhe i urave ne konstruksion metalik.

Projektim dhe ndertim i konstruksioneve metalike per ndertim serash per frutikulture e bujqesi.

Import, eksport, tregtimi me shumice dhe pakice i produkteve dhe artikujve te meposhtem:

Te gjitha llojet e

inputeve te ndryshme bujqesore, i ushqimeve te njerezve dhe te kafsheve me origjine bimore dhe shtazore, i plehrave

kimike dhe organike, farerave dhe fidaneve bujqesore dhe dekorative, produkteve te mbrojtjes se bimeve (pesticide,

insecticide, fungicide, herbicide dhe ekstrakte dhe vajrave heterike).

Tregtim dhe shitje te naftes dhe nenprodukteve te saj.

Bar klub, restorant, organizim te eventeve te ndryshme, aktivite artistike, sportive, hoteleri, qendra masazhi, kurativ.

Import, eksport, tregtim te produkteve te ndryshme te perdorimit te perditshem ne spitale dhe shendetesi,

medikamntet me origjine bimore, hapje spitalesh dhe klinikave private, produkte kozmetike me origjine bimore

(kremra, xhel, tableta etj), reagent kimike (baza, acide, kripera etj) me qellim perdorimin per analizat ne spitalet dhe

laboratore, esenca te ndryshme ne fushen e kimise dhe biologjise, produkte kimike, detergjente, tretesa etj,

produkteve veterinare, import-eksport dhe tregetim me shumice dhe pakice i pajisjeve te ndryshme te perdorimit mjekesor dhe kite te analizave ne mjekesi.

Projektimin dhe Ndertimin e ndertesave per banim si dhe tregetimin e tyre.

Projektim dhe ndertim rruges, vepra te ndryshme industriale, ndertime ne fushen e bujqesise etj.

Blerja, shitja, dhenia me qira, nenqira e pasurive te paluajtshme, dhenia me qira e pasurive luajtshme dhe te paluajtshme te shoqerise, duke respektuar dispozitat e ligjit ne fuqi.

Prodhim te artikujve te ndryshme qe perdoren ne fushen e ndertimit si berone, inerte, mermere etj. si dhe tregetimi i tyre.

Plan vendosje objektesh te vecanta kat 3.a, b.

Projektues konstruktor.

Rikonstrukcion godinash civile dhe ekonomike, veshje fasadash etj

Ndertim ujesjelles kanalizime, ndertim vepra kullimi, ujitje etj..

Ndertim veprash arti te vogla deri ne 6 metra. Punime dheu, sistemime, tarcime terrenesh ndertime civile ekonomike etj.

Import eksport dhe tregetim me shumice dhe pakice te rrobave te gatshme, tekstile,metrazhe etj.

Import – eksport i aparaturave imazherike dhe aksesoreve te tyre, apartatura dentare dhe aksesore, aparatura laboratorike si dhe hapjet e depova farmaceutike, ofrimi i sherbimeve nderhyrese higjieno-sanitare si dezinfektim dhe procese te tjera.

Hapje te kopshteve, shkollave 9-vjecare, shkolla te mesme si dhe universitete e kurse apsuniversitare.

Per me teper Shoqeria mund te kryeje cdo aktivitetet tjeter i cili nuk eshte i ndaluar nga ligji ne fuqi.

Shoqeria do te kryeje cdo lloj aktiviteti ne raport me objektin dhe per te favorizuar ate.

Shoqeria zbaton dhe respekton te gjitha ligjet dhe rregulloret perkatese. Ajo zbaton standardet me te larta te etikes.

Neni 3:
Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë **ME AFAT TE PA PERCAKTUAR**
(vetëm nëse është e përcaktuar):

Neni 4:
Selia

(1) Selia e shoqërisë ndodhet ne adresën: **RRUGA E KAVAJES, APARTAMENTI 23, KATI 2, PRAPA QENDRES GLOBE, TIRANE**

(2) Adresa e faqes së internetit të shoqërisë është (nëse ka): www.tafa.al

(3) Adresa e shoqërisë për qëllime komunikimi elektronik është si vijon (nëse ka):
tafaxhino@gmail.com

Kreu II Kapitali

Neni 5 Kapitali themeltar

(1) Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është **100 000 Lekë** (*sipas ligjit kapitali nuk mund të jetë më i vogël se 100 lekë*). Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

1. Ortaku themelues **XHINO Tafa** : Zoterues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 100 000 LEKE që përben 100 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta)

Neni 6:

Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nepermjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nepermjet emerimit nga gjykata kompetente e nje eksperti te autorizuar per keto kontribute sipas kërkesës së administratorit.

Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

Neni 7 Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, për sa nuk parashikohet ndryshe ne statut.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

KREU III ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 8 Organi Vendimmarres

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.

Asambleja e përgjithshme e ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat “c” dhe “ç” të kësaj pike; dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve; gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

Neni 9 Mënyra e thirrjes se mbledhjes se Asamblese se Pergjithshme

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

Neni 10 Kuorumi

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave.

Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit “ Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare “, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuoromit të përmendur me lart, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Neni 11 Marrja e vendimeve

Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të zoteruesve të kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera si :

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- ç) përcaktimin e shpërblimeve
- d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

Cdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKR për të pasqyruar ndryshimet në skeden e shoqërisë.

Neni 12 Përjashtimi nga e drejta e votës

1.Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:

- a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
- b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
- c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
- ç) dhënien ose jo të përfitimeve të reja.

2.Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

Neni 13 Administrimi

(1) Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit, është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

(2) Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, sipas përcaktimit të nenit 207 të këtij ligji, nuk mund të emërohen si administratorë të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.

(3) Personat e mëposhtëm caktohen si Administratorë të parë të shoqërisë deri në emërimin e tyre nga mbledhja e parë e Asamblesë së Përgjithshme. Administraor I shoqërisë emërohet z. Xhino Tafa

Neni 14 Kompetencat e Administratorëve

Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:

a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme; b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;

c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;

ç) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;

d) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;

dh) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;

e) raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

ë) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Administratorët janë të detyruar të theksin Asamblenë e Përgjithshme, në rastet kur: -sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.

-shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

-shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 15 Përgjegjësia e Administratorit

Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit “Per Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare“, administratori detyrohet:

1. a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;

b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;

c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;

ç) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personale me ata të shoqërisë;

d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

3. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidarë.

4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit „ Per Tregtaret dhe Shoqërite Tregtare , kryen veprimet e mëposhtme:

a) u kthen ortakëve kontributet;

b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;

c) u shpërndan aktivet shoqërisë;

ç) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;

d) jep kredi.

Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose se bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit

Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

Kreu IV Viti financiar-ekspertet

Neni 16 Viti Financiar

Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqërisë ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 17 Ekspertet

Eksperti ka per detyre qe të kontrolloje të gjithë dokumentacionin kontabel të veprimtarisë ekonomiko tregtare të shoqërisë, ate gjithëvjetor dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij per rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer nje gje të tille i ngarkuar nga ana e ortakeve.

Ne perfundim të kontrollit eksperti kontabel i autorizuar per gatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe per ate per kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar qe t'ja paraqese e dorezoje ne kohe ortakeve per t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazen e të drejtes vendimore qe ka.

Kreu V Prishja –riorganizimi i shoqërisë

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vednimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare.”

Neni 20 Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 21 Mosmarrëveshjet

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tjerëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

ORTAKET

E SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR *

*EMERTIMI I SHOQËRISË**

TAFA 07 SH.P.K

XHINO TAFA

